



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

Raportimi dhe Përgatitja e Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Seksioni 1

Pyetje me alternativa (1 pikë secila)

Zgjidhni alternativën e saktë

- 1. Sipas SNK 8 “Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet”, cila nga këto ndryshime klasifikohet si ndryshim në politikat kontabël:**
 - a. Rritja e provigjionit për llogaritë e arkëtueshme në vonesë nga 5% në 10% të shumës së papaguar;
 - b. Ndryshimi i metodës së vlerësimit të inventarit nga FIFO në atë të kostos mesatare;**
 - c. Ndryshimi i metodës së amortizimit të makinerive dhe pajisjeve nga amortizimi linear në metodën e amortizimit të vlerës së mbetur;
 - d. Ndryshimi i jetës së dobishme të automjeteve nga gjashtë vjet në katër vjet;
 - e. Sistemi i pasqyrave financiare të një filiali para konsolidimit, nëse politikat e tij kontabël ndryshojnë nga ato të shoqërisë mëmë;
 - f. Ulja e vlerës së inventarit nga kosto në vlerën neto të realizueshme për shkak të rregullimit si pasojë e ngjarjeve pas periudhës së raportimit;
 - g. Asnjëra nga të mësipërmet;
 - h. Të gjitha të mësipërmet.

Përgjigja e saktë alternativa B

- 2. Cila nga alternativat nuk është e nevojshme të pasqyrohet në formatin e pasqyrës së pozicionit financiar, por paraqitet si pjesë e shënimeve shpjeguese?**
 - a. Aktivet totale afatgjata;
 - b. Kapitali i pronarëve;
 - c. Detyrimet afatgjata;
 - d. Kostoja dhe amortizimi i akumuluar i aktiveve afatgjata materiale;**
 - e. Të drejtat e arkëtueshme;
 - f. Inventarët;
 - g. Shpezimet e shtyra;
 - h. Mjetet monetare.

Përgjigja e saktë alternativa D

- 3. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me diferencat e përkohshme, duke patur parasysh kërkesat e SKK 11- “Tatimi mbi fitimin”:**
- a. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme të tatueshme;
 - b. Një detyrim tatimor i shtyrë njihet për diferencat e përkohshme të zbritshme;
 - c. Një detyrim tatimor i shtyrë paraqitet në pasqyrat financiare si zë afatshkurtër ose afatgjatë, në varësi të kohës kur ai pritet të paguhet nga njësia ekonomike;
 - d. Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për diferencat e përhershme të zbritshme;
 - e. Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra, llogariten në bazë të normës së tatimit mbi fitimin të vitit aktual;
 - f. Një njesi ekonomike duhet të masë një detyrim apo aktiv tatimor të shtyrë duke përdorur normat dhe ligjet tatimore që janë miratuar ose janë në thelb të miratuara deri në datën e raportimit;**
 - g. Një njesi ekonomike duhet të masë një detyrim apo aktiv tatimor të shtyrë duke përdorur normat dhe ligjet tatimore që janë në diskutim për t’u miratuar në periudhat e ardhshme;
 - h. Asnjëra.

Përgjigja e saktë alternativa F

- 4. Sipas SKK 1, shpenzimet që lidhen me gjenerimin e përfitimeve ekonomike gjatë periudhave të ardhshme raportuese njihen:**
- a. Në pasqyrën e pozicionit financiar si aktiv kur ato kryhen;**
 - b. Në pasqyrën e pozicionit financiar si pasiv kur ato kryhen;
 - c. Si detyrim gjatë periudhës raportuese kur ato priten të gjenerojnë përfitime ekonomike;
 - d. Në retrospektivë në momentin e ndodhjes së tyre;
 - e. Alternativa b) dhe c);
 - f. Asnjëra.

Përgjigja e saktë alternativa A

- 5. Një njesi ekonomike që tregoton materiale ndërtimi është në procesin e përcaktimit të vlerës kontabël të gjendjes së inventarit më 30.09.2020 për mbylljen e pasqyrave të ndërmjetme financiare. Informacioni që disponon departamenti i shitjeve të njesisë është se çmimi i tregut për kategorinë A të produkteve ka rënë në 300 Lek për copë ndërkohë që kosto për këtë kategori produkti është 320 Lek për copë. Departamenti i shitjeve gjithashtu vlerëson se 600 copë gjendje të produktit në kategorinë A do të mund të shiten gjatë tremujorit të fundit të vitit 2020 për 305 Lek për copë.**
- a. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A është 180,000 Lek;**
 - b. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A është midis 180,000 dhe 183,000 Lek;
 - c. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A është 183,000 Lek;
 - d. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A është midis 183,000 dhe 192,000 Lek;
 - e. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A është 192,000 Lek;
 - f. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A nuk mund të përcaktohet me këto të dhëna;

- g. Vlera kontabël e inventarit për kategorinë A do të përcaktohet në momentin e shitjes;
- h. Informacioni që merret nga departamenti i shitjeve nuk është relevant për vlerësimin kontabël të inventarit.

Përgjigja e saktë alternativa A

- 6. Në cilat nga rastet qiraja e thjeshtë nuk do të klasifikohet si qira financiare?**
- a. Qiraja transferon pronësinë e aktivitetit tek qiramarrësi në fund të afatit të qirasë;
 - b. Qiramarrësi ka opsionin për ta blerë aktivitetin me një çmim që pritët të jetë mjaft më i ulët se vlera e drejtë në datën kur ky opsion bëhet i ushtrueshëm dhe ka një siguri të arsyeshme, që në fillimin e qirasë, që opsioni do të ushtrohet;
 - c. Afati i qirasë përfshin pjesën më të vogël të jetës ekonomike të aktiveve, edhe nëse titulli i pronësisë nuk është transferuar;**
 - d. Aktivitetet e dhëna me qira janë të një natyre të veçantë në mënyrë të tillë që vetëm qiramarrësi mund t'i përdorë ato pa iu bërë modifikime të mëdha.

Përgjigja e saktë alternativa C

- 7. Sipas SKK 3, cila nga pikat nuk plotëson kushtet e njohjes si instrumenta financiarë:**
- e. Investimeve në aksione preferenciale të pakonvertueshme dhe të pashitshme;**
 - f. Llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme;
 - g. Obligacione dhe instrumenta të ngjashme borxhi;
 - h. Zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare;
 - i. Të gjitha të mësipërmet;
 - j. Asnjëra.

Përgjigja e saktë alternativa E

- 8. Sipas kërkesave të SNRF 10, një njesi ekonomike mëmë e një grupi, mund të mos përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara në rast se:**
- a. Njësitë ekonomike në të cilat ajo ka investuar kanë një natyrë aktiviteti shumë të ndryshëm nga njeri-tjetri;
 - b. Njësitë ekonomike në të cilat ajo ka investuar kanë data të ndryshme të mbylljes së pasqyrave financiare;
 - c. Njësitë ekonomike në të cilat ajo ka investuar aplikojnë standarde të ndryshme kontabël në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale;
 - d. Plotësohen kriteret 1 dhe 2;
 - e. Plotëson kriteret 1 dhe 3;
 - f. Plotësohen kriteret 1, 2 dhe 3;
 - g. Shoqëria mëmë përfundimtare ndërton dhe publikon pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF;**
 - h. Nëse kërkesa për mos-përgatitje të pasqyrave financiare të konsoliduara është miratuar nga autoritetet përkatëse sipas legjislacionit në vendin ku njesia mëmë ushtron aktivitetin e saj.

Përgjigja e saktë alternativa G

9. Emri i mirë që gjenerohet në një kombinim biznesi raportohet në pasqyrat financiare si:

- a. Aktiv afatgjatë material;
- b. Aktiv afatgjatë jo-material;**
- c. Aktiv afatshkurtër;
- d. Aktiv financiar;
- e. Detyrim financiar kundrejt njësië ekonomike mbi të cilën ushtrohet kontroll;
- f. Detyrim financiar kundrejt interesit të pakicës;
- g. Aktiv i kontrolluar bashkarisht midis njësisive në një kombinim biznesi;
- h. Aktivitet i kontrolluar bashkarisht midis njësisive në një kombinim biznesi.

Përgjigja e saktë alternativa B

10. Në bazë të SKK 11- Tatimi mbi fitimin, diferencat e përkohshme lindin:

- a. Kur, në njohjen e aktiveve ose detyrimeve, ka një diferencë mes vlerave kontabël dhe bazave tatimore të tyre, ose kur krijohet një bazë tatimore (për ato zëra që kanë një bazë tatimore) por nuk njihet asnjë aktiv apo detyrim;
- b. Kur, pas njohjes, lind një diferencë mes vlerës kontabël dhe bazës tatimore, për shkak se e ardhura ose shpenzimi njohet në kapital në një periudhë raportuese të caktuar, ndërkohë që në fitimin e tatueshëm njihet në një periudhë raportuese tjetër;
- c. Kur, baza tatimore e një aktivi ose detyrimi ndryshon dhe ndryshimi nuk ndikon në vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit, në asnjë periudhë raportuese;
- d. Kostoja e një kombinimi biznesesh shpërndahet mbi bazën e vlerës së drejtë të aktiveve të identifikueshme të blera/përfuara dhe të detyrimeve të marra, ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon;
- e. Aktivet rivlerësohen ndërkohë që baza tatimore e tyre nuk ndryshon;
- f. Alternativat a) dhe b);
- g. Alternativat a), b) dhe e);
- h. Alternativat a), b), c), d) dhe e).**

Përgjigja e saktë alternativa H

Seksioni 2

Pyetje me zhvillim (4 pikë secila)

11. Sipas kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si një institucion me rëndësi dhe mision të veçantë i janë caktuar një sërë detyrash që duhet të përmbushë. Përmendni disa prej detyrave që duhet të përmbushë Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duke specifikuar rolin e këtij institucioni.

Përgjigje :

Referuar Ligjit, KKK ka disa detyra si më poshtë:

- a. të hartojë SKK, në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe në koherencë të plote me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- b. të përpunojë një sistem kontabël, ku, përveç standardeve kombëtare të kontabilitetit, të përcaktojë rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, si dhe formatet për pasqyrat financiare;
- c. të evidentojë nevojat dhe të propozojë zgjidhjet për përmirësimin e metodave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe për kualifikimet;
- d. të botojë SKK dhe materiale të tjera për zbatim në lidhje me këto standard
- e. të monitorojë zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- f. të vendosë marrëdhënie me organizata profesionale vendase e të huaja dhe të marrë pjesë në veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare për kontabilitetin;
- g. të interpretojë dhe të përgjithësojë problemet që dalin nga praktika dhe standardet kontabël, të cilat i paraqet në formën e udhëzimeve kontabël;

12. Shpjegoni se çfarë kuptohet me termin aktive neto, aktive neto të kufizuara dhe aktive neto të pakufizuara. Shpjegoni shkurtimisht në cilat raste përdoren termat aktive neto të kufizuara dhe të pakufizuara në pasqyrat e pozicionit financiar.

Përgjigje:

Aktivi neto është **diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të OJF-së në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. (1 pikë)**

Aktivet neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur nga donatori, ndahen në: - aktive neto të kufizuara, dhe - aktive neto të pakufizuara;

Aktivet neto të kufizuara janë **burime të kufizuara nga donator/ët**. Kufizimet e donatorëve mund të kërkojnë që burimet të përdoren **në një periudhë të mëvonshme ose pas një date të caktuar** (kufizim në kohë), ose ato burime të përdoren për një qëllim të caktuar (kufizimi i qëllimit), ose të dyja bashkë, p.sh, dhuratat në mjete monetare apo aktive të tjera me përcaktimin që të investohen për të siguruar një burim të ardhurash për një afat të caktuar dhe gjithashtu, kjo e ardhur të përdoret për një qëllim të caktuar. Sa më sipër janë kufizime në kohë dhe në qëllim. Këto dhurata shpesh quhen dhurata me afat. **(1 pikë)**

Aktivet neto të pakufizuara zakonisht janë **rezultat i ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, marrjes së kontributeve të pakufizuara**, marrja e dividendëve apo interesave në aktive që gjenerojnë të ardhura, pakësuar me shpenzimet që ndodhin gjatë ofrimit të shërbimeve, prodhimit dhe shpërndarjes së mallrave, krijimit të fondeve dhe realizimit të funksioneve administrative. **(1 pikë)**

Të vetmet kufizime në përdorimin e aktiveve neto të pakufizuara janë ato kufizime që **buarojnë nga natyra e vetë organizatës**, mjedisi në të cilin ajo operon dhe qëllimet e specifikuar në statutin e themelimit të saj apo në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore si dhe kufizime që buarojnë nga marrëveshjet kontraktuale me furnitorët, kreditorët dhe të tjerë palë të lidhura me organizatën në rrjedhën e aktivitetit të saj. **(1 pikë)**

13. Shprehni dallimet midis aktiveve afatshkurtër dhe aktiveve afatgjatë, si dhe detajoni arsyet kur një njesi duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër, si dhe kur duhet të klasifikojë një aktiv afatgjatë.

Përgjigje:

Aktivet afatshkurtra nga aktivet afatgjata dallohen nga 4 kritere të cilat përdoren për të vlerësuar aktivet afatshkurtra.

Një njesi ekonomike duhet të klasifikojë një aktiv si afatshkurtër kur:

(a) ajo **pret të realizojë aktivin**, ose ka ndërmend ta shesë apo ta konsumojë atë, brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; **(0.5 pikë)**

(b) ajo e **mban aktivin kryesisht për qëllime tregtimi**; **(0.5 pikë)**

(c) ajo pret të realizojë aktivin **brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit**;ose **(0.5 pikë)**

(d) **aktivi është mjet monetar ose një ekuivalent i mjeteve monetare**, nëse nuk është i kufizuar për t'u përdorur për shkëmbim ose të përdoret për të shlyer një detyrim për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit. **(0.5 pikë)**

Një njesi ekonomike duhet të **klasifikojë të gjitha aktivet e tjera si afatgjata**. Kur cikli normal i njësisë ekonomike nuk është i identifikueshëm qartë, **kohëzgjatja e tij supozohet të jetë dymbëdhjetë muaj. (2 pikë)**

14. Tregoni çfarë janë vlerësimet kontabël? Nga ndryshojnë vlerësimet kontabël nga politikat kontabël? Tregoni se si mund të sistemohen në kontabilitet efektet e ndryshimeve në vlerësimet kontabël dhe politikat kontabël duke dhënë nga një shembull për secilin rast.

Përgjigje:

Vlerësimet kontabël, janë çmuarje të cilat nuk bazohen në fakte të vëzhguara në mënyrë objektive, ose ndryshe janë regjistrime të cilat bazohen në një shumë që përcaktohet përmes një matje jo të saktë. Raste të vlerësimeve kontabël janë vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve, vlerësimi i jetës së dobishme të AAM-ve dhe AAJM-ve si dhe përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit si dhe krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.

Politika kontabël e zgjedhur zbatohet në mënyrë të qëndrueshme nga viti në vit. Një ndryshim në politikat kontabël do të zbatohet në retrospektivë, d.m.th sikur politika e re të ishte zbatuar gjithnjë. Informacioni krahasues i periudhave kontabël të mëparshëm rishikohet në mënyrë të tillë që të jetë i paraqitur në përputhje me politikën e re kontabël. Si shembull do të përdorej rasti kur njësia ekonomike ndryshon politikën kontabël të

vlerësimet të inventarëve, për shembull nga vlerësimi i tyre me metodën FIFO në vlerësimin e tyre me metodën e kostos mesatare të ponderuar.

Ndryshimet në vlerësimet kontabël vijnë nga informacioni i ri apo zhvillimet e reja dhe përkatësisht nuk janë korrigjime të gabimeve. Ndryshimet në vlerësimet kontabël do të njihen gjatë periudhës kontabël kur ato kanë ndodhur, dhe jo në retrospektivë. Nëse supozojmë që një shoqëri ka blerë një pajisje 1,000 usd për të cilën është vlerësuar jetëgjatësia 5 vjet, pra me një amortizim 200 usd në vit, por pas tre vitesh vlerëson se jetëgjatësia e saj është vetëm 1 vit, atëherë nga ndryshimi i kësaj çmuarje kontabël shoqëria do të ndryshoj nivelin e amortizimit për vitet (3 dhe 4) që pasojnë por nuk prek rezultatet e viteve të mëparshme.

15. Shpjegoni çfarë janë sipërmarrjet e përbashkëta sipas përcaktimit të SKK 14 “Trajtimi Kontabël i Investimeve në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta” si dhe cilat janë tre format e sipërmarrjeve të përbashkëta.

Përgjigje:

Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje kontraktuale sipas të cilës dy apo më shumë palë ndërmarrin një veprimtari ekonomike që është subjekt i kontrollit të përbashkët. Sipërmarrjet e përbashkëta mund të jenë në tre forma:

1. Aktivitete të kontrolluara së bashku. Funksionimi i disa sipërmarrjeve të përbashkëta kërkon përdorimin e aktiveve dhe burimeve të tjera të sipërmarrësve dhe jo krijimin e një njësie ekonomike tjetër, apo të një strukture financiare që është e ndarë nga vetë sipërmarrësit. Çdo sipërmarrës përdor aktivet afatgjata materiale të veta, dhe inventarët e vet. Ai gjithashtu kryen shpenzimet e veta, ka detyrimet e veta dhe siguron financimet e tij, të cilat krijojnë detyrimet e tij. Aktivitetet e sipërmarrjes së përbashkët mund të kryhen nga punonjësit e sipërmarrësit përbri aktiviteteteve të ngjashme të sipërmarrësit. Marrëveshja e përbashkët e sipërmarrjes zakonisht përbën mjetin me anën e të cilit të ardhurat nga shitja e produktit të përbashkët dhe çdo shpenzim i bërë në mënyrë të përbashkët ndahen midis sipërmarrësve.
2. Aktive të kontrolluara së bashku. Disa sipërmarrje të përbashkëta kërkojnë kontrollin e përbashkët, dhe shpesh pronësinë e përbashkët, nga sipërmarrësit të një ose më shumë aktiveve të kontribuara, ose të fituara për qëllim të sipërmarrjes së përbashkët dhe të dedikuar për qëllimet e sipërmarrjes së përbashkët.
3. Njësi ekonomike të kontrolluara së bashku. Një njësi ekonomike e kontrolluar bashkërisht është një sipërmarrje e përbashkët që përfshin krijimin e një korporate, shoqërie të thjeshtë ose të njësie ekonomike tjetër në të cilën çdo pjesëmarrës ka një interes. Njësia ekonomike vepron në të njëjtën mënyrë si njësitë ekonomike të tjera, përveç se një marrëveshje kontraktuale midis sipërmarrësve vendos kontroll të përbashkët mbi veprimtarinë ekonomike të njësisë.

16. Si trajtohen AMM dhe AAJM të mbajtura për shitje përsa i përket njohjes dhe vlerësimit të tyre? Si llogaritet amortizimi? A mund të përdoret nga njësia ekonomike një aktiv i mbajtur për shitje?

Përgjigje:

Me aktive të mbajtura për shitje kuptojmë elementë të AAM dhe AAJM, që priten të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm pas datës së raportimit, të cilat riklasifikohen si aktive afatgjata të mbajtura për shitje dhe paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive afatshkurtra. Elemente të AAM-së dhe AAJM-së riklasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar si aktive afatgjata të mbajtura për shitje vetëm dhe vetëm nëse ato janë të disponueshme për shitje të menjëhershme dhe shitja e tyre është shumë e mundshme (1 pikë)

Aktivet afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, vlerësohen me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Ato paraqiten më vete në pasqyrën e pozicionit financiar. (1 pikë)

Amortizimi i aktiveve afatgjata, të klasifikuara si të mbajtura për shitje, ndërpritet në kohën e riklasifikimit të aktivitetit. Nëse vlera e drejtë e aktivitetit (minus koston e përlogaritur të shitjes) është më e ulët se vlera kontabël e tij, aktiviteti i klasifikuar si i mbajtur për shitje do të zvogëlohet deri në vlerën e drejtë (minus koston e shitjes). (1 pikë)

Një aktiv afatgjatë i klasifikuar si i mbajtur për shitje, mund të përdoret nga njësia ekonomike deri në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose shitjes por me kushtin që nuk amortizohet. (0.5 pikë)

Nëse një njësi ekonomike i ndryshon planet e saj në lidhje me shitjen e aktivitetit, aktiviteti riklasifikohet si AAM ose AAJM, duke i vlerësuar me vlerën më të ulët midis vlerës së tyre kontabël të mëparshme (e rregulluar me amortizimin e akumuluar) dhe shumës së rikuperueshme. Rregullimi, në lidhje me riklasifikimin e mundshëm, njihet në pasqyrën e performancës të periudhës kontabël, dhe jo në mënyrë retrospektive. (0.5 pikë)

17. Cilat janë katër llojet e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse të cilat sipas SKK 2 janë pjesë e pasqyrës së performancës, por jashtë fitimit/humbjes së vitit.

Përgjigje:

a) fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga përkthimi i pasqyrave financiare të një veprimtarie të huaj – trajtohen sipas SKK 12 - Efekti i ndryshimit të kurseve të këmbimit. (1 pikë)

b) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale në vlerë të drejtë sipas trajtimit alternativ të lejuar – trajtohen sipas SKK 5 - Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale. (1 pikë)

c) fitimet që rrjedhin nga rivlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura për shitje – trajtohen sipas SKK 3 –Instrumentet Financiare. (1 pikë)

d) Pjesa e të ardhurave gjithëpërfshirëse nga pjesëmarrjet – trajtohen sipas SKK 9- Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta. (1 pikë)

Shenim: pikët mund të jepen të plota edhe pa cilësimin e numrit specifik të SKK me të cilën trajtohen, përsa kohë tregohet njohuri se trajtimi i këtyre të ardhurave rregullohet me SKK specifike.

18. Cilat janë dy metodat për trajtimin e granteve qeveritare që lidhen me aktivet?

Përgjigje:

SNK 20 'Kontabiliteti i granteve qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare'

Grantet qeveritare që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar ose duke e njohur grantin si të ardhur të shtyrë ose duke zbritur grantin nga vlera e mbartur e aktivit.

Dy metodat e paraqitjes në pasqyrat financiare të granteve që lidhen me aktivet janë:

- Njëra metodë njih grantin si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivit. (2 pikë)
- Metoda tjetër zbrit grantin që merret nga vlera kontabël e aktivit. Granti njihet si e ardhur gjatë jetës së aktivit të amortizueshëm duke pakësuar shumën e amortizimit. (2 pikë)

19. Bazuar në SNRF 3, çfarë kërkon zbatimi i metodës së blerjes?

Përgjigje:

Bazuar në SNRF 3, zbatimi i metodës së blerjes bëhet sipas hapave të mëposhtëm:

- Identifikimin e blerësit;
- Përcaktimin e datës së blerjes;
- Njohja dhe matja e aktiveve të identifikueshme të blera, detyrimet e marra përsipër dhe çdo interes jo-kontrollues tek i bleri;
- Njohjen dhe matjen e emrit të mirë ose të një fitimi nga një blerje e volitshme

20. Cilat janë dy metodat e raportimit të flukseve të mjeteve monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit? Shpjegoni me një fjali secilën metodë, si dhe shpjegoni 2 elementë ku këto metoda ndryshojnë nga njëra-tjetra.

Përgjigje:

Dy metodat e raportimit të flukseve të mjeteve monetare janë metoda direkte dhe metoda indirekte. **(0.5 pikë)**

Me metodën direkte shpjegohen klasat kryesore të arkëtimeve / pagesave bruto në para. **(1 pikë)**

Me metodën indirekte, ku fitimi/humbja e vitit rregullohet për efekte të transaksioneve jo monetare (çdo shtyrje ose rritje e arkëtimeve ose pagesave të shkuara ose të ardhshme dhe zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve lidhur me investimin ose financimin e fluksit të mjeteve monetare. **(1 pikë)**

Metoda indirekte shton shpenzimet e amortizimit, shton uljen në të arketueshmet, heq rritjen e inventarit, heq uljen e të pagueshmeve.

Metoda direkte ka vetëm zërat: cash nga klientet, cash i paguar te punonjësit, cash i paguar te furnitorët, cash i paguar për interesat. *(mjaftojnë dy nga këto ndryshime në zëra krahasime për të marrë 1 pikë)*

Pavarsisht përgatitjes së ndryshme të metodës direkte dhe indirekte, rezultati me të dyja metodat është i njëjtë. **(1 pikë)**

Seksioni 3

Ushtrime (5 pikë secili)

21. Kompania Slims Sha. Ka humbje tatimore të mbartura për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 në Shumen 2,000,000. Humbja e mbartur i përket viteve 2018 dhe 2019, përkatësisht në shumën 500,000 dhe 1,500,000 lekë. Në bazë të legjislativës tatimore, kompania ka të drejtë që t'i mbartë humbjet tatimore kundrejt fitimeve të ardhshme të tatueshme, deri në 3 vjet.

Kompania rezulton edhe për vitin 2020 sërish me humbje tatimore në shumën 300,000 lekë. Ndërsa, në 4 vitet e ardhshme, duke filluar nga viti 2021 parashikon një fitim të tatueshëm si më poshtë:

Viti	2021	2022	2023	2024
Fitim/(humbje)	900,000	1,400,000	1,000,000	1,200,000

Kompania Slims sha parashikon që dhe pas vitit 2024 të rezultojë me fitim para tatimit. Ajo është subjekt i një norme tatimit mbi fitimin prej 15 %.

Kërkohet: Në bazë të informacionit të mësipërm, shpjegoni nëse kompania Slims sh.a duhet që të njohë ndonjë aktiv tatimor të shtyrë ose detyrim tatimor të shtyrë për vitin 2020 në lidhje me humbjet e mbartura dhe në çfarë shume.

Përgjigje:

Në bazë të legjislativës tatimore, humbjet tatimore të akumuluar mund të përdoren për llogaritjen e fitimit të tatueshëm neto të viteve të ardhshme dhe në rastin tonë ato mund të përdoren deri në 3 vjet, duke perdour më parë humbjen me të hershme të realizuar.

Një njesi ekonomike duhet të njohë një aktiv tatimor të shtyrë për humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është i mundur realizimi i të ardhurave të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. (1 pikë)

Ne rastin e kompanisë Slims Sha. duhet njohur një aktiv tatimor i shtyrë për humbjet e mbartura, deri në masën që humbjet e mbartura në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare më 31.12.2020, parashikohet të përdoren kundrejt fitimeve para tatimit të periudhave të ardhshme. (1 pikë)

Në bazë të parashikimit që ka bërë kompania për 4 vitet e ardhshme, mund të gjykojmë se e gjithë shuma e humbjeve të akumuluar në fund të vitit 2020 duke përfshirë dhe humbjen e vitit 2020 (në total 2,300,000) lekë do mund të përdoret e gjitha brenda 3 viteve të ardhshme. Më konkretisht, humbja e vitit 2018 do mund të përdoret në llogaritjet e tatimit mbi fitimin për vitin 2021, humbja e vitit 2019 do përdoret pjesërisht në llogaritjet e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 (400,000 lekë) dhe pjesërisht në llogaritjen e tatimit mbi fitimin për vitin 2022 (1,000,000 lekë). Ndërsa humbja e vitit 2020 do mund të përdoret në llogaritjen e fitimit të tatueshem të vitit 2023. Për rrjedhojë, Kompania Slims Sha. duhet të njohë një aktiv tatimor të shtyrë në shumën $15\% \times 2,300,000 = 345,000$ lekë. (3 pikë)

22. Shoqëria Beta shpk ofron një vit garanci për të gjitha mallrat e shitura gjatë vitit. Gjatë vitit 2019, shoqëria ABC shpk ka shitur 6,000 njësi. Përvoja e së kaluarës dhe pritjet e ardhshme tregojnë se në 85 % të rasteve, mallrat e shitura prej saj nuk kanë patur asnjë nevojë për riparime gjatë vitit të parë pas blerjes. Mesatarisht 10% e mallrave të shitura gjatë vitit kanë nevojë për riparime të vogla, dhe vetëm 5 % kanë nevojë për riparime të mëdha. Drejtimi ka përllogaritur që nëse do të nevojiteshin riparime të vogla për të gjitha mallrat e shitura, kjo do t'i kushtonte shoqërisë 12,000,000 lekë. Gjithashtu, drejtimi ka vlerësuar se 4 nëse të gjitha mallrat e shitura do të kishin nevojë për riparime të mëdha, kjo do t'i kushtonte shoqërisë 100,000,000 lekë.

Kërkohet: llogarisni vlerën e provizionit. (2 pikë)

- Shoqëria Beta shpk mund të përballet me një çështje të mundshme ligjore si pasojë e dëmtimit në punë të një punonjësi të saj gjatë vitit 2019 për shkak të një defekti në makineri.

Kërkohet: Çfarë detyrimesh për provizione do t'i lindin shoqërisë si pasojë e dëmtimit të punonjësit apo dëmtime në të ardhmen? (1 pikë)

- Në janar 2020 shoqëria Beta shpk paditet nga punonjësi I dëmtuar në punë si pasojë e një defekti në makineri. Këshilltarët ligjorë besojnë se ka të ngjarë që beta shpk të humbasë çështjen gjyqësore kundër punonjësit dhe duhet të paguajë 2 milion lekë dëmshpërblim. Beta shpk është e vendosur të ngrejë një kundërpadi kundër prodhuesit të makinerisë për çështjet e sigurisë. Këshilltarët ligjorë besojnë se ka një shans 80 % që padia kundër prodhuesit të ketë gjasa të ketë sukses dhe besojnë se Beta shpk do të fitonte 1.5 milion.

- **Kërkohet:** Llogarisni vlerën e provizionit. (2 pikë)

Përgjigje:

a) Provizioni do të jetë:

$(85\% \times 0 \text{ Lekë}) + (10\% \times 12,000,000 \text{ Lekë}) + (5\% \times 100,000,000 \text{ Lekë}) = 6,200,000 \text{ Lekë.}$

(2 pikë)

b) Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të njohë provizion për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Ngjarja e ndodhur në vitin 2019 mund të çojë në një detyrim, por deri në momentin e përgatitjes së pasqyrave financiare ende nuk ka patur ndonjë pretendim të mundshëm nga pala e dëmtuar. Sipas SNK 39 nuk do të njohë asnjë provizion nëse nuk ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) që është rrjedhojë e një ngjarje të shkuar. **(1 pikë)**

c) Në këtë rast, Beta Shpk do të njohë një provizion për humbjen prej 2 milion Lekë në detyrime. Edhe pse ekziston një gjasë që Beta Shpk të fitojë kundërpadinë, ky përbën Aktiv të kushtëzuar dhe si i tillë nuk mund të njihet në pasqyrat financiare të kompanisë. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare meqenëse kjo mund të rezultojë në njohjen e të ardhurave që nuk do të realizohen kurrë.

(2 pikë, 1 pikë për njohjen e provizionit prej 2 milion dhe 1 pikë për identifikimin e kundërpadisë si një aktiv të kushtëzuar).

23. Ju jeni kontabilisti i Mango shpk, një biznes që blen dhe shet pajisje sportive. Balancat për 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

Kapitali i nënshkruar		5000
Fitimet e pashpërndara 1 janar 2019		5835
Të ardhura		66980
Shpenzimet e stafit	5400	
Inventari më 1 janar 2019	3930	
Blerjet	38760	
Kosto distribucioni	3130	
Shpenzime administrative	3790	
Shpenzime interesi	200	
Të ardhura nga investimet		250
Tatime	200	
Të ardhura dhe të arkëtueshme	9290	2360
Banka	3125	
Mjete transporti – kosto	5000	
Ndërtesat - kosto	12000	
Mjete transporti – amortizimi i akumuluar		1000
Ndërtesat - amortizimi i akumuluar		2400
Obligacionet (2021)		100
Total	84.825	84.825

- Mango nuk ka blerë as nuk ka shitur aktive afatgjata gjatë vitit. Politika e amortizimit është si më poshtë:
- Mjete transporti – 20 % të vlerës së mbetur
- Ndërtesa – 25 vjet lineare
- Inventari në fund të vitit u vlerësua në vlerën 4,000.
- Balanca e detyrimeve tregon një mbi/nën pagesë për vitin e mëparshëm. Parashikohet një detyrim prej 1,500 për tatimet që duhet të paguhet në fund të vitit.

Kërkohet: Përgatisni pasqyrën e performancës për vitin 31 dhjetor 2019.

Përgjigje:

Mjete transporti

Kosto	5,000	
Amortizimi akumuluar	-1,000	
	<u>4,000</u>	
Amortizimi @ 20%	-800	
	<u>3,200</u>	(1 pikë)

Ndërtesat

Kosto	12,000	
Amortizimi akumuluar	-2,400	
	<u>9,600</u>	
Amortizimi (12,000/25)	-480	
	<u>9,120</u>	(1 pikë)

Vlera e Aktive Afatgjata = 3,200 + 9,120 = 12,320

Kostos e shitjes = shpenzimet e stafit + shpenzimet e amortizimit + inventari në fillim + Blerje – Inventari në fund = 5,400 + 800 + 480 + 3,930 + 38,760 – 4,000 = 45,370 **(1 pikë)**

Pasqyra e performancës më 31 dhjetor 2019 **(2 pikë për formatin e pasqyrës së performancës dhe vendosjen e vlerave në zërat e duhur)**

Të ardhura	66,980
Kostot e shitjes	(45,370)
Fitimi bruto	21,610
Shpenzime distribicioni	(3,130)
Shpenzime administrative	(3,790)
Fitimi operativ	14,690
Kosto financimi	(200)
Të ardhura nga investimi	250
Fitimi para tatimit	14,740
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	(1,500+200)
Fitimi neto	13,040

24. Një ekstrakt nga pozicioni financiar i Delia shpk është si më poshtë:

31 dhjetor 2019

Inventari 7.4 milion Lek

Gjithashtu, disponohet informacioni i mëposhtëm:

Nga kryerja e inventarit fizik më 31 dhjetor 2019, u identifikuan dy çështje si më poshtë:

- Disa produkte me vlerë shitjeje 0.3 milion lek nuk ishin përfshirë në gjendjen e mbylljes së inventarit.
- Disa produkte të përfshira në gjendjen e inventarit me kosto 0.2 milion lek u gjendën të dëmtuara dhe u vlerësua se mund të shiteshin me jo më shumë se 50 % të çmimit të zakonshëm të shitjes.

Kërkohët: Nëse politika e njësisë ekonomike Delia shpk është që të përcaktojë çmimin e shitjes duke aplikuar një marzh fitimi 50 % mbi koston e produkteve, përcaktoni cila është vlera e saktë kontabël e gjendjes së inventarit të njësisë ekonomike më 31.12.2019 (tregoni dhe shpjegoni llogaritjet tuaja).

Përgjigje:

Sipas SKK 4 Inventarët, njësia ekonomike duhet ta vlerësojë inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Gjendjes paraprake të raportuar të inventarit në masën **7.4 milion Lek** i duhet shtuar edhe vlera e produkteve me vlerë shitje 0.3 milion Lek që u gjend gjatë numërimit fizik. Meqënëse njësia aplikon një marzh fitimi 50% mbi koston e produkteve, kosto e kësaj gjendje inventari është:

$(0.3 \text{ milion Lek} / 1.5) = \mathbf{0.2 \text{ milion Lek}}$

Produktet të cilat u gjendën të dëmtuara duhet të përfshihen në vlerën e inventarit me vlerën e tyre neto të rekuverueshme.

Në gjendjen normale këto produkte do të shiteshin për 0.3 milion Lek (0.2 milion \times (1+50%)) meqënëse njësia aplikon një marzh fitimi 50% mbi koston e produkteve, por për shkak të dëmtimit, këto produkte mund të shiten vetëm me 50% të çmimit të zakonshëm të shitjes, pra për 0.15 milion Lek.

Kjo do të thotë, që rënia e vlerës për këto produkte të duhet reflektuar në gjendjen e inventarit është **0.05 milion Lek** (0.2 milion Lek – 0.15 milion Lek), pra diferenca e koston me vlerën neto të realizueshme.

Duke marrë parasysh këto rregullime gjendja përfundimtare e inventarit që duhet të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar të Delia është:

$7.4 \text{ milion Lek} + 0.2 \text{ milion Lek} - 0.05 \text{ milion Lek} = 7.55 \text{ milion Lek}$

25. Argumento përgjigjen për njohjen e kontributeve.

Me qëllim mbledhjen e fondeve, Departamenti I Baletit në Kolegjin e Arteve organizoi një concert ku dot ë performonte një balerin shumë i njohur. Biletat e aktivitetit u shitën për një çmim 3.000 lekë dhe përfshihej në çmim një pritje cocktail përpara shfaqjes (vlera e drejtë 350 lekë), pranimi në concert (vlera e drejtë 400 leke) si dhe një pritje me balerinët pas shfaqjes (vlera e drejtë 200 lekë).

- Janë biletat e kësaj shfaqjeje të veçantë artistike një kontribut?

Përgjigje:

Teprica mes çmimit të biletës (3.000 lekë) dhe vlerës së drejtë të shpenzimeve të përballuara (950 lekë) përfaqëson masën e kontributit (2.050 lekë).

Një fondacion shumë i njohur, I cili ka në programin e tij të mbështesë shaqjet teatrale, I jep fonde Departamentit të Arteve në Kolegjin e Arteve. Donatori (Fondacioni) specifikon se fondet do të përdoren për të mbështetur shfaqjet dhe performancat e artistëve. Si pjesë e programit të tij të zakonshëm, departamenti i arteve I përdor këto fonde për të kompensuar artistë individual që performojnë në kolegji dhe japin mësim në klasa të ndryshme të nivelit master.

- Është ky një kontribut?

Përgjigje:

Po. Kolegji i arteve nuk vepron si një ndërmjetës për këta artistë. Fondet mbështesin një program të vazhdueshëm të departamentit të arteve dhe duhet të njihen si kontribut.

26. Shoqëria XCV shpk është e specializuar në prodhimin e kontruksioneve metalike. Ajo zotëron një sharrë prerëse të blerë më 1 janar 2019. Sharra përbëhet nga dy element kryesorë me vlerë 600,000 lekë dhe 100,000 lekë. Elementi i parë përfshin edhe vlerën aktuale të detyrimeve të ardhshme të çmontimit. Jeta e dobishme e çdo elementi është 10 dhe 5 vite. Procesi i prerjes prodhon element helmues të cilët ndotin ambientin. Legjislacioni kërkon pastrimin e zonës deri në vitin 2029. Në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019, vlera e mbetur e provizionit ishte 193,600 lekë. Norma e skontimit e përdorur është 10%. Më 1 janar 2019, shoqëria mori edhe një grant qeveritar në vlerën 120,000 lekë që lidhen me koston e elementit të parë. Granti paraqitet veçmas në pasqyrën e pozicionit financiar.

Më 1 korrik 2021, qeveria ndryshoi ligjin për mbrojtjen e ambientit sipas të cilave i kërkohej shoqërisë që të vendoste filtra pastrimi brenda furrës brenda dy vitesh. Filtrat ndikojnë ndjesëhm në uljen e ndotjes së shkaktuar nga furra e shoqërisë dhe rrjedhimisht edhe provizionin e ngritur për pastrimin e zonës në vitin 2028. Megjithatë, më 31 dhjetor 2021, shoqëria nuk e kishte montuar ende filtrin.

Kërkohet:

- Vlera kontabël neto e furrës më 31 dhjetor 2021;
- Vlerat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit 2021;
- Cili është trajtimi kontabël në lidhje me legjislacionin e rid he a ka shoqëria një detyrim të kushtëzuar në datën e mësipërme.

Përgjigje:

- a. Vlera kontabël neto e furrës më 31 dhjetor 2021:

Elementi i parë i furrës (mbeten 7 vite) $600,000 * 7/10 = 420,000$

Elementi i dytë i furrës (mbeten 2 vite) $100,000 * 2/5 = 40,000$

Total 460,000

- b. Vlerat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit 2021:

Amortizimi i furrës elementi 1 $600,000/10 = 60,000$

Amortizimi elementi $100,000/5 = 20,000$

Njohja të ardhurave nga granti $120,000/10 = (12,000)$

Skontimi i provizionit për vitin $193,600 \times 10\% = 19,360$

Totali i ndikimit në shpenzime të vitit 87,360

- c. Shoqëria nuk ka ende një detyrim për instalimin e filtrave pasi legjislacioni ka hyrë në fuqi gjatë vitit dhe ka lënë 2 vjet afat për përshtatje. Për rrjedhojë, kërkesat e reja nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të vitit. Gjithashtu, shoqëria nuk ka as detyrim të kushtëzuar në datën e raportimit pasi detyrimi i saj lind në të ardhmen dhe sipas përkufizimeve të SNK 37, detyrimet e kushtëzuara lindin nga ngjarje të shkuara dhe janë detyrime aktuale dhe jo të ardhshme

27. Një distributor produktesh kozmetike, është paditur nga një prej klientëve të saj për shkak se një prej linjave të parfumeve që ajo tregton ka rezultuar me cilësi shumë të dobët. Sipas vlerësimit të zyrës juridike, në rast të humbjes së çështjes gjyqësore, ajo ka një mundësi prej 40% që të dëmshpërblejë klientin e saj kundrejt një shume prej 2 milion lekë dhe 60% mundësi kundrejt një shume prej 1 milion lekë. Nga ana tjetër, ky distributor ka ngritur një padi gjyqësore kundrejt prodhuesit të këtij parfumi për t'u kompensuar për dëmet e shkaktuara. Ajo ka kërkuar që të dëmshpërblehet kundrejt një shume prej 500,000 mijë lekë që përfaqëson fitimin e humbur sipas kontratës me prodhuesin, si dhe mbulimin e të gjitha shpenzimeve të pritshme gjyqësore që mund të lindin kundrejt klientit të saj. Sipas vlerësimit të zyrës juridike, ajo ka 40% mundësi që të humbasë gjyqin kundrejt prodhuesit të parfumit dhe në këtë rast do mund të përfitonte vetëm dëmshpërblimin prej 500,000 lekë të sipërpërmendur. Në rast se e fiton gjyqin ndaj prodhuesit, distributor do përfitonte shumën prej 500,000 lekë si dhe të paktën

gjysmën e shpenzimeve gjyqësore që mund të lindin nga gjyqi që ajo ka me klientin e saj.

Kërkohet: Duke supozuar se të gjitha ngjarjet e mësipërme kanë ndodhur në vitin 2020, tregoni nëse duhet të reflektohen ato në pasqyrat financiare të këtij viti dhe nëse po, si duhet të paraqiten.

Përgjigje:

Drejtimi i njësisë ekonomike (distributor i produkteve kozmetike) duhet të vlerësojë në përgatitjen e pasqyrave nëse duhet të njohë ose jo një provizion për padinë gjyqësore të ngritur nga klienti i saj. Në bazë të SKK 6 - *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Kushtëzuara*, një provizion njihet në pasqyrat financiare nëse plotëson kushtet e një detyrimi aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Në rastin konkret, ngjarja detyruese ka ndodhur dhe kemi të bëjmë me një detyrim aktual, por që ka pasiguri për shumën dhe kohën se kur do paguhet ky detyrim, ne varësi të vendimit të çështjet gjyqësore. Në këtë rast kemi të bëjmë me një detyrim të vetëm dhe provizioni duhet njohur me vlerësimin më të mirë të shumës së mundshme për të paguar detyrimin., Pra, duhet njohur një Provizion në shumën 1,000,000 lekë duke qënë se konsiderohet dhe si shuma apo vlerësimi me i mundshëm për të ndodhur. **(2 pikë)**

Padia gjyqësore që ka ngritur distributori kundrejt prodhuesit të parfumit në lidhje me dëmet e shkaktuara, duhet ndarë në 2 elemente. Në bazë të vlerësimit të zyrës juridike të njësisë ekonomike, shuma prej 500,000 lekësh që përfaqëson dëmshpërblimin nga prodhuesi, mund të konsiderohet pothuajse e sigurtë, pasi pavarisht rezultatit të procesit gjyqësor ndaj prodhuesit, kjo shumë pritet të paguhet me siguri nga prodhuesi. Prandaj, shuma prej 500,000 lekë, duhet të njihet në pasqyrat financiare të vitit 2020 si një kërkesë e arkëtueshme ndaj prodhuesit. **(1.5 pikë)**

Pretendimi i paraqitur nga njesia ekonomike për tu kompensuar edhe për gjysmën e shpenzimeve gjyqësore që mund të lindin ndaj klientit të saj, mund të konsiderohet si një Aktiv i kushtëzuar, pasi përbën një kërkesë te mundshme që lind nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike. Ne lidhje me këtë pretendim, njesia ekonomike nuk duhet të njohë asnjë shumë në pasqyra financiare të vitit 2020. Megjithatë, njesia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues në pasqyrat financiare te vitit 2020, nisur më shumë nga rëndësia që mund të ketë kjo ngjarje për shkak të natyrës sesa për shkak të propabilitetit që ka njesia ekonomike për ta perfituar këtë kompensim. **(1.5 pikë)**

28. Një njesi ekonomike , në ditët e fundit të vitit kontabël të mbyllur më 31 dhjetor 2019, ka inventarin e mëposhtëm fizik dhe kostot e lidhura me:

Produkti	Njesi	Kostot e materialeve të para (në lekë)	Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (në lekë)	Kostot e transaksionit të shitjes (në lekë)	Çmimi I shitjes (në lekë)
A	300	19,200	1,800	1,440	22,200
B	250	6,000	1,200	1,200	9,000

Kërkohet: Në çfarë shume do të prezantohen inventarët në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhje me SNK 2?

Përgjigje:

Inventarët maten me **shumën më të ulët** të kostos dhe vlerës neto të realizueshme. **(1 pikë për këtë pohim).**

Kosto është shuma e kostos së materialeve të para plus shpenzimet e përgjithshme të prodhimit. Vlera neto e realizueshme është diferenca mes cmimit të shitjes dhe kostos së transaksionit.

Shuma e inventarit në pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2019 është **8,028,000 Lekë** dhe përlogaritjet si më poshtë:

Produkti	Njësi	Kosto (në Lekë)	VNR (në Lekë)	Shuma më e ulët (në Lekë)	Vlera Inventarit (në Lekë)
A	300	21,000	20,760	20,760	6,228,000
B	250	7,200	7,800	7,200	1,800,000
Totali					8,028,000

(4 pikë, e shpërndarë në: 1 pikë për llogaritjen e kostos, 1 pikë për llogaritjen e VNR, 2 pikë për llogaritjen e vlerës së inventarit)

29. Më 1 Mars 2020 një njesi ekonomike i dha një paradhënie page në formë huaje një punonjësi për një periudhë gjashtë mujore, në shumën 60,000 lekë. Norma e interesit e tregut për huatë konsumatore është 10%. Punonjësi do ta shlyejë pagesën me këste të barabarta.

Kërkohet: Cilat janë regjistrimet që duhet të bëjë njesia ekonomike|?

Përgjigje:

Paradhënia e pagës në formën e huasë do të trajtohet si një aktiv financiar afatshkurtër. Sipas SKK 3 Instrumentat e borxhit që janë të klasifikuara si aktive afatshkurtër ose detyrime afatshkurtër duhet të maten me shumën e paskontuar të mjeteve monetare ose shumave të tjera të pritshme për t'u paguar ose arkëtuar përveçse kur marrëveshja përbën, në efekt, një transaksion financiar. (1 pikë)

Në rastin në fjalë nuk ka kosto të transaksioneve të paguara ose të marra apo prime ose zbritje të tjera. Duke duke qenë se huaja është dhënë për një periudhë gjashtëmujore nuk do të zbatohet metodën e interesit efektiv. Si periudhë raportimi do të merret data e fundit të cdo muaji.

Huaja do të njihet nga njesia ekonomike në shumën 60,000 lekë. Çdo muaj do të paguhet principlali dhe do të paguhet interesat e llogaritur mbi vlerën e mbetur të principlalit.

Regjistrimi kontabël në njohjen fillestare janë:

Debi - Paradhënie page 60,000

te

Kredi - Mjete monetare 60,000

Regjistrimi kontabël i pagesës së principalit dhe të ardhurave nga interesi në bazë mujore:

Muaji Mars

Debi - Paga të pagueshme 10,500

te

Kredi - Paradhënie page 10,000

Kredi – Të ardhura nga interesat 500

Duke qenë se interesat do të njihen dhe paguhen mbi bazë mujore dhe principalit në vlerë fikse, amortizimi i huasë dhe kontabilizimi do të behet cdo muaj sipas të dhënave të tabelës në vijon:

Muaji	Vlera kontabël në fillim të muajit	Interesi 10% në vit	Principalit	Kesti	Vlera kontabël në fund të cdo muaji
Mars	60,000	500	10,000	10,500	50,000
Prill	50,000	417	10,000	10,417	40,000
Maj	40,000	333	10,000	10,333	30,000
Qershor	30,000	250	10,000	10,250	20,000
Korrik	20,000	167	10,000	10,167	10,000
Gusht	10,000	83	10,000	10,083	-
Totali		1,750	60,000	61,750	

Shënim: norma vjetore e interesit vjetor do të kthehet në bazë mujore duke e pjesëtuar për 12 muaj. (4 pikë)

30. Njesia ekonomike Home SH.A ushtron aktivitetin e saj në shitjen e pajisjeve elektroshtëpiake të vogla, për të cilat ofron dhe garanci një vit për dëmtimet e mbuluara nga garancia. Dy nga pajisjet e saj më të shitura janë:

- Fshesat e markës XYZ dhe
- Shtrydhëset e frutave të markës ABC

Në bazë të historikut të saj, ajo ka konstatuar se për fshesat e markës XYZ, 90% e pajisjeve nuk kanë defekte, 8% kanë defekte të vogla dhe 2% kanë defekte serioze. Riparimi i defekteve të vogla ka kushtuar zakonisht rreth 10% të çmimit të shitjes, ndërsa riparimi i defekteve serioze rreth 80% të çmimit të shitjes së pajisjeve. Ndërsa për shtrydhëset e frutave të markës ABC, nga historiku i shitjeve rezulton se vetëm 5% e pajisjeve të shitura rezultojnë me defekt, kryesisht në motorin elektrik, riparimi i të cilit i ka kushtuar kompanisë sa gjysma e çmimit të shitjes. Gjatë vitit 2020 ajo ka shitur rreth 1,000 fshesa të markës XYZ me një çmim 14,000 lekë pa TVSH si dhe 600 shtrydhëse të frutave të markës ABC, me një çmim 8,000 lekë pa TVSH.

Kërkohe: Tregoni veprimet kontabël që duhet të kryejë Home SH.A për vitin 2020 për njohjen e provizionit për shitje, duke patur parasysh gjithashtu se për të dy produktet e mësipërme ka kryer aktualisht disa riparime pajisjesh me kosto totale 700,000 lekë.

Përgjigje:

Në këtë rast njësia ekonomike jep garanci për produktet që ajo shet, e cila konsiderohet edhe si ngjarja detyruese që lind që në momentin e shitjes së një produkti me garanci. Për rrjedhojë, njësia ekonomike duhet të njohë në pasqyrat e saja financiare të vitit 2020, një provizion për garancinë i barabartë me shumën e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të garancisë për produktet e shitura deri në datën e raportimit. Për vlerësimin e provizioneve do të merret për bazë përvoja e mëparshme dhe vlerësimi i provizionit në momentin e njohjes duhet të pasqyrojë vlerën e pritshme të gjitha rezultateve të mundshme me probabilitetet e tyre përkatëse.

Vlerësimi i provizionit për Fshesat e markës XYZ:

Vlera e pritshme = $90\% \times 0 + [8\% \times (0.1 \times 14,000 \text{ lekë/njesi}) + 2\% \times (0.8 \times 14,000 \text{ lekë/njesi})] \times 1,000 \text{ njesi} = 336,000 \text{ leke. (1 pikë)}$

Vlerësimi i provizionit për Shtrydhëset e frutave të markës ABC.

Vlera e pritshme = $95\% \times 0 + 5\% \times (0.5 \times 8,000 \text{ lekë/njesi}) \times 600 = 120,000 \text{ lekë. (1 pikë)}$

Shuma totale e provizionit për garanci = $336,000 + 120,000 = 456,000 \text{ lekë.}$

Rregjistrimi kontabël për njohjen e provizionit: (1 pikë)

Debi: Shpenzime provizioni garancie	456,000 lekë
Kredi: Provizion garance	456,000 lekë

Meqënëse njësia ekonomike gjatë të njëjtit vit ekonomik ka patur dhe shpenzime riparimi në shumën 700,000 lekë për riparimet e dy produkteve të shitura, shuma e njohur fillimisht si provizion duhet të merret plotësisht sipas veprimit të mëposhtëm kontabël **(1 pikë):**

Debi: Provizion garancie	456,000 lekë
Kredi: Shpenzime për provizion garancie	456,000 lekë

(Pranohet si zgjidhje edhe nëse kandidatët kanë zgjedhur që në kredi të njohin një të ardhur nga rimarrja e provizionit)

Për rrjedhojë në datën e raportimit, njësia ekonomike nuk ka ndonjë shumë për tu paraqitur si provizion garancie në pasqyrat e saj financiare të vitit 2020, në lidhje me njohjen fillestare të provizionit të garancisë për shitjet e realizuara gjatë vitit 2020.

Megjithatë Home SH.A duhet të rishikojë vlerësimin e provizionit të garancisë dhe të gjitha provizioneve në teërësi, në datën e raportimit dhe do t'i rregullojë ato për të pasqyruar vlerësimin më të mirë të shumës që do të kërkohe për të shlyer detyrimin në atë datë të raportimit.

Ne rastin konkret, ky vlerësim i provizionit duhet të reflektojë afatin e mbetur të garancisë së ofruar, arsyet e ndryshimit në vlerësimin fillestar etj. **(1 pikë)**

